



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:250142

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05738402

P.nr. 33/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurit N.J, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2176/22 e datës 26.01.2023, në bazë të nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP), dhe neneve 14, 15, 17 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seancë me datë **15.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër të lëndës në ndërmjetësim **ND.nr.69/24 e datës 19.03.2024**, në mes të pandehurit N.J, në njërën anë dhe palës së dëmtuar Hasan Berisha, në anën tjetër.
- II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2176/22 e datës 26.01.2023 dhe **PUSHOHET** procedura penale, kundër të pandehurit **N.J**, i lindur me datë në fshatin Z., ku edhe jeton rr. “24 Q.” Komuna I., me nr. personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.
 - *Për shkak se i pandehuri dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është aprovuar zyrtarisht nga gjykata.*
- III. Marrëveshja e arritur** në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të këtij dispozitivi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2176/22 e datës 26.01.2023 kundër të pandehurit N.J për shkak te veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.03.2024, ne te cilën seancë i pandehuri N.J ka propozuar që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, qe me palën e dëmtuar të arrijë marrëveshje.

Gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka marrë mendimin e palëve prezente në seancë – të dëmtuarit H.B i cili është pajtuar qe kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 2, 4, 8 dhe 12 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 229 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka aprovuar propozimin e të pandehurit që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit ngase akoma nuk ka përfunduar afati ligjor prej 90 ditësh qe palët të arrijnë marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, ndërsa **me Vendimin e datës 19.03.2024**, e ka referuar këtë çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog.

Gjykata **me datë 19.03.2024**, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar me:

- **Modelin e Marrëveshjes për Ndërmjetësim** (Shtojcën 2), sipas të cilës rezulton se palët e lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, janë pajtuar për ta zgjidhur kontestin e tyre në procedurën e ndërmjetësimit, dhe
- **Marrëveshjen për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar** (Shtojcën 3), sipas të cilës rezulton se ndërmjet palëve të lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit. E cila marrëveshje pasi që është nënshkruar edhe nga ndërmjetësuesi, është proceduar në gjykatë te gjyqtari i çështjes për aprovim.

Gjykata me **Vendimin e datës 22.03.2024** (shtojcën 5), e ka pranuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform nenit 15 te Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje tani e tutje është dokument i ekzekutueshëm.

Sipas nenit 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata e hedhë aktakuzën dhe e pushon procedurën kur: *“ i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata ”*.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, duke vlerësuar se marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve është e paraparë dhe në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe pas aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës, e duke vepruar konform nenit të sipërcituar 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit si në pikën II, të diapozitivit të këtij aktvendimi.

Konstatimi në pikën III, të diapozitivit të këtij aktvendimi, bazohet në nenin 229 par.6 të KPP-së dhe nenin 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, që nënkupton se, në rastet kur palët nuk i përmbushin brenda afatit detyrimet e përcaktuara në marrëveshje, atëherë pala e dëmtuar mund që të kërkojë nga Përmbaruesi Privat apo gjykata që e njëjta të ekzekutohet me forcërisht.

Gjykata vendimin në pikën IV, të diapozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale e ka marrë konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të neni 248 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA ISTOG

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

GJYQTARI,

Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. *Në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.*